EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8431
E premte, 17 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

IKShPK: 336 raste me fruth në Kosovë, 37 të reja vetëm gjatë javës së fundit FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA NDALON TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE ME KOMPANI SERBE, SHPALL MASA EMERGJENTE PËR 60 DITË FAQE 4-5



Qeveria e Kosovës e ka ndaluar tregtimin e energjisë elektrike me kompani serbe të energjisë, për shkak të, siç tha, vendimit të Serbisë për t'i mbajtur të bllokuara linjat ndërkufitare për tregtim. Duke folur në një mbledhje të kabinetit të tij qeveritar të hënën, kryeministri Albin Kurti tha se Kosova po vendos kundërmasa ndaj Serbisë në fushën e energjisë, sepse "gjendja do të përshkallëzohet në të ardhmen, nëse nuk ka reflektim" nga shteti fqinj

OPOZITA, QEVERISË: PASKAN QENË TË VËRTETA PAZARET ME RRYMËN E SERBISË DHE MAFIAN ENERGJETIKE F. 3



SKANDAL NË BRUKSEL | KËNGA NACIONALISTE SERBE KUNDËR KOSOVËS INTERPRETOHET NË FORUMIN E ZGJERIMIT TË BE-SË, PRISHTINA KËRKON SQARIME NGA BRUKSELI F. 3



AKTUALE



UKRAINA PËRGATITET PËR TAKIME KYÇ ME ALEATËT, NDËRSA SULMET RUSE VAZHDOJNË F. 2

KURTI RAPORTON PËR VIZITAT NË PARIS DHE DUBLIN: ZHVILLUAM MBI 30 TAKIME ME LIDERË NDËRKOMBËTARË F. 5

PRESIDENTJA NË 10-VJETORIN E NALT-it: ANËTARËSIMI NË NATO MBETET SYNIMI STRATEGJIK I KOSOVËS F. 6

EKONOMI



AKB-ja: PROTESTAT DHE TENSIONET NË SHQIPËRI PO FRENOJNË INVESTIMET KOSOVARE DHE PO RRISIN PASIGURINË EKONOMIKE F. 8

GERXHALIU: INFLACIONI NË KOSOVË NUK E PASQYRON PLOTËSISHT BARRËN EKONOMIKE TË QYTETARËVE F. 8

SPORT



ADEMI, MESAZH FUTBOLLISTËVE SHQIPTARË: NËSE NUK E ZGJIDHNI KOSOVËN, ZGJIDHENI SHQIPËRINË F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

UKRAINA PËRGATITET PËR TAKIME KYÇ ME ALEATËT, NDËRSA SULMET RUSE VAZHDOJNË

KIEV, 16 NËNTOR - Derisa bisedimet për paqe po hasin në vështirësi dhe sulmet ajrore ruse po vazhdojnë, Qeveria e presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky, po përgatitet për dy takime të rëndësishme me aleatët këtë javë: takimin e të ashtuquajturit Grupi i Ramsteinit, i cili do të pasohet nga një takim i Koalicionit të Vullnetit.

Këto takime do të mbahen në një kohë kur Rusia nuk po jep asnjë shenjë gatishmërie për t'i dhënë fund luftës. "Do të mbahet një takim i Ramsteinit, i cili duhet të sjellë rezultate", tha Zelensky në fjalimin e tij të mbrëmjes, të publikuar me video më 15 nëntor, duke iu referuar takimit të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, i cili është planifikuar të mbahet më 17 nëntor në Bruksel. "Ky takim do të dërgojë mesazh të fortë për Rusinë, se Ukraina nuk do të mbetet pa mbështetje", shtoi Zelensky.

I njohur jozyrtarisht si Grupi i Ramsteinit, ky grup bashkërendon mbështetjen ushtarake për Ukrainën nga aleatët perëndimorë. Takimin e ardhshëm do ta udhëheqin ministrat e Mbrojtjes së Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe.

Lideri ukrainas tha se synimet kryesore të Kievit janë forcimi i mbrojtjes ajrore të vendit, përfshirë sigurimin e raketave dhe sistemeve shtesë Patriot, si dhe të sistemeve kombëtare të avancuara të raketave kundërajrore, NASAMS. "Kërcënimi nga raketat balistike ruse mbetet shumë serioz dhe ne kemi të dhënat të inteligjencës që tregojnë se po përgatiten sulme të reja", tha Zelensky.

Ukraina po përballet me vështirësi për t'i mbrojtur qytetet nga dronët rusë me motorë reaktivë, të cilët mund të fluturojnë pothuajse dy herë më shpejt se modelet e vjetra. Për këtë arsye, Kievi ka kërkuar përshpejtimin e dërgesave të armëve më të avancuara mbrojtëse nga Perëndimi.

Takimi i Koalicionit të Vullnetit "mund të jetë historik"

Zelensky tha se Ukraina po përgatitet gjithashtu për një takim në Berlin të Koalicionit të Vullnetit, të cilin e cilësoi si "një takim të rëndësishëm që mund të jetë historik".

Kancelari gjerman, Friedrich Merz, presidenti francez, Emmanuel Macron, dhe kryeministri britanik, Andy Burnham, do ta udhëheqin takimin e këtij koalicioni. Ky është një grupim joformal, i krijuar në fillim të vitit 2025 nga shtetet që janë zotuar ta ndihmojnë Kievin dhe që mund të marrin pjesë në një forcë shumëkombëshe paqeruajtëse, në rast se arrihet marrëveshje për armëpushim.

Merz tha se në takim pritet të marrin pjesë më shumë se 20 krerë shtetesh dhe qeverish. "Qëllimi ynë është të arrijmë dy gjëra: së pari, të sigurojmë financimin për mbrojtjen e Ukrainës për vitin 2027 dhe, së dyti, të arrijmë një qëndrim të përbashkët lidhur me bisedimet e ardhshme për paqe", tha ai.

Zelensky tha se "e kemi mundësinë të krijojmë një qëndrim vërtet të fortë dhe të unifikuar evropian për negociatat". "Po përgatitim gjithashtu një vlerësim të punës së koalicioneve ekzistuese që mbështesin Ukrainën, cilat prej tyre po i përmbushin vërtet detyrat dhe, cilat, për të qenë të sinqertë, kanë mbetur vetëm struktura boshe. Do të punojmë për t'u dhënë përmbajtje", tha ai.

Më 9 nëntor, Koalicioni i Vullnetit nisi stërvitjen e parë ushtarake, e cila synon të



mbështesë periudhën e mundshme të pasluftës në Ukrainë.

Rreth 3.000 ushtarë nga 11 shtete po marrin pjesë në këto manovra, të cilat kanë për qëllim testimin e mënyrave për të ruajtur paqen pas arritjes së një armëpushimi që do t'i jepte fund luftës.

Stërvitja, e udhëhequr nga Franca dhe Britania e Madhe, po zhvillohet në Poloni, në hapësirën ajrore mbi Rumaninë dhe në pjesën perëndimore të Detit të Zi. Ajo pritet të zgjasë deri më 22 nëntor.

Moska e kritikoi ashpër këtë stërvitje, duke e akuzuar koalicionin se po përgatitet për luftë me Rusinë.

Rusia dhe Ukraina vazhdojnë sulmet

Ndërkohë, Rusia dhe Ukraina vazhduan shkëmbimin e sulmeve ajrore, disa ditë pasi një sërë aktivitetesh diplomatike, të ndërmjetësuara nga Shtetet e Bashkuara, nuk sollën përparim në përpjekjet për t'iu afruar një marrëveshjeje për paqe.

Një sulm rus në Dnipro, më 16 nëntor, vrau të paktën një person dhe plagosi tre të tjerë, ndërsa një tjetër sulm goditi një objekt të rëndësishëm industrial në rajonin e Vinitsias, në pjesën perëndimore-qendrore të Ukrainës.

Në rajonin e Zaporizhjas, një sulm me dron rus vrau një grua 64-vjeçare dhe plagosi dy persona të tjerë, ndërsa dy persona u vranë në një sulm rus në Çernihiv, raportuan zyrtarët ukrainas më 16 nëntor.

Sulmet ruse me dronë shënjestruan gjithashtu objektet energjetike në rajonin e Çerkasit, në Ukrainën qendrore, duke lënë disa konsumatorë pa energji elektrike.

Ndërkohë, autoritetet e vendosura nga Rusia në Krime raportuan për një sulm ndaj Urës së Kerçit, e cila lidh gadishullin e pushtuar ukrainas me territorin kontinental të Rusisë. Sulmi ndodhi në mëngjesin e 16 nëntorit dhe shkaktoi kufizime të qarkullimit të automjeteve.

Gjatë natës, afro 600 dronë shënjestruan rajonin e Moskës, ndërsa 191 prej tyre u interceptuan pranë Moskës, pretendoi kryetari i bashkisë së qytetit, Sergei Sobyanin, në një postim në Telegram më 16 nëntor.

Një sulm tjetër me dronë raportohet se shkaktoi zjarr pranë dy depove të naftës në qytetin jugor rus Azov, në rajonin e Rostovit, sipas kanaleve të Telegramit që monitorojnë zhvillimet.

Autoritetet e rajonit të Rostovit thanë se në Azov ishte shpallur gjendje e jashtëzakonshme lokale pas një sulmi me dronë. Sipas zyrtarëve, zjarre shpërthyen në katër objekte industriale në qytet, por ata nuk dhanë hollësi të tjera.

Shtabi i Përgjithshëm i Ukrainës konfirmoi sulmin, duke thënë se forcat ukrainase goditën një depo nafte pranë Rostov-on-Donit, të cilën e përshkroi si një qendër të rëndësishme logjistike për grupimin ushtarak rus në jug të vendit.

Duke folur për sulmet ukrainase me rreze të gjatë veprimi ndaj objekteve energjetike ruse, Zelensky tha se Ukraina kishte nxjerrë jashtë funksionit më shumë se 55 për qind të kapaciteteve të Rusisë për rafinimin e naftës. "Kjo është përgjigjja jonë e justifikuar ndaj refuzimit të Rusisë për t'i ulur tensionet dhe ndaj sulmeve të saj kundër infrastrukturës energjetike të Ukrainës", shtoi ai.

Ndërkohë, princi britanik Harry u takua me ushtarë të plagosur gjatë luftimeve, në kuadër të një vizite dyditore në Ukrainë, e cila nuk ishte njoftuar paraprakisht. Kjo ishte vizita e tij e katërt në vend që nga pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia, në shkurt të vitit 2022. "Ju do ta fitoni luftën dhe më pas do të krijohen kushtet që ju të keni sukses", tha ai gjatë një konference për personelin mjekësor, të organizuar nga Superhumans, një klinikë e specializuar për personat e plagosur në luftë.

Harry mori pjesë në aktivitete më 14 dhe 15 nëntor në qytetin perëndimor të Ukrainës, Lviv. Deklaratat e tij u bënë publike vetëm më 15 nëntor, pasi ai ishte larguar nga Ukraina, për arsye sigurie.

MES DEBATIT PËR DËBIMIN E AFGANËVE, LIGJVËNËSIT AMERIKANË SHTYJNË PËRPARA LIGJIN PËR MBROJTJEN E TYRE



UASHINGTON, 16 NËNTOR - Planet e SHBA-së për të dëbuar 150 afganë drejt vendit të tyre përmes Pakistanit kanë sjellë frikë për sigurinë e tyre dhe kanë nxitur një varg seancash gjyqësore, të cilat deri më tani kanë penguar nisjen e fluturimit.

Por, këtë javë, aktivistët dhe ligjvënësit kanë promovuar në Kapitolin amerikan një projektligj që synon të sigurojë mbrojtje afatgjatë për mijëra afganë në të gjithë Shtetet e Bashkuara.

Demokratët do të mund ta imponojnë mbajtjen e një votimi në Dhomën e Përfaqësuesve kur shumica e tyre e re të marrë kontrollin e Kongresit në janar. Por, këtë javë janë mbajtur dhjetëra takime me synimin për të siguruar mbështetje dypartiake, duke pasur parasysh urgjencën e situatës lidhur me fluturimet e planifikuara. "Çështja është që të përpiqemi ta miratojmë sa më shpejt gjatë këtij mandati, për të siguruar që të ushtrojmë presion për ndalimin e këtyre fluturimeve", i tha Radios Evropa e Lirë kongresisti demokrat, Scott Peters. "Po punojmë edhe me republikanë që mendojmë se mund ta mbështesin këtë nismë".

Autoritetet amerikane ua hoqën mijëra afganëve Statusin e Mbrojtjes së Përkohshme (TPS) në maj të vitit të kaluar. "Situata e sigurisë në Afganistan është përmirësuar dhe ekonomia e tij, e cila po stabilizohet, nuk i pengon më ata të kthehen në vendin e tyre", tha në atë kohë sekretarja e atëhershme e Sigurisë Kombëtare, Kristi Noem.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

SKANDAL NË BRUKSEL | KËNGA NACIONALISTE SERBE KUNDËR KOSOVËS INTERPRETOHET NË FORUMIN E ZGJERIMIT TË BE-së, PRISHTINA KËRKON SQARIME NGA BRUKSELI

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Një koncert që synonte të promovonte bashkimin e kulturave evropiane nxiti reagime politike, pasi në të u interpretua melodia e një kënge serbe që e paraqet Kosovën si pjesë të Serbisë.

Polemika bëri që komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos, të shprehte keqardhje për përzgjedhjen e saj.

Ngjarja ndodhi më 15 nëntor në Bruksel, gjatë mbrëmjes hapëse të Forumit të Zgjerimit të Bashkimit Evropian, të organizuar nga Komisioni Evropian.

Në koncertin e titulluar "Meloditë e unitetit: Harmoni nga udhëkryqi i Evropës", krahas pjesëve muzikore nga vendet e përfshira në procesin e zgjerimit, u interpretua edhe melodia e këngës serbe "Oj Kosovo, Kosovo".

Teksti i kësaj kënge përmban pretendime territoriale ndaj Kosovës dhe kundërshton heqjen dorë prej saj.

Gjatë koncertit, megjithatë, nuk u këndua vargjet e kësaj kënge. U interpretua vetëm melodia, ndërsa titulli u shfaq në ekran, sipas dëshmive të pjesëmarrësve.

Përfshirja e saj në një aktivitet të Komisionit Evropian nxiti reagime nga zyrtarët e Kosovës dhe raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, të cilët kërkuan shpjegime për mënyrën e përzgjedhjes së repertorit.

Në një prononcim për gazetarët, më 16 nëntor, Kos shprehu keqardhje për përzgjedhjen e kësaj kënge nga muzikantët, duke theksuar se ajo nuk pasqyron në asnjë mënyrë as qëndrimin e Komisionit Evropian, as qëndrimin e saj personal ndaj Kosovës dhe historisë së saj.

Ajo tha se është e vetëdijshme për vuajtjet dhe sakrificat e njerëzve në këtë pjesë të Evropës gjatë së kaluarës dhe theksoi rëndësinë e pajtimit, pa harruar dallimet dhe përvojat historike.

"Ne nuk kërkojmë që dallimet të harrohen, por po ndërtojmë një Evropë ku dallimet nuk do të jenë arsye për të penguar të ardhmen", tha Kos.







Çfarë dihet për këngën?

Kënga "Sa Kosova zora svića" - në shqip "Nga Kosova zbardh agimi" - e njohur edhe si "Oj Kosovo, Kosovo", u krijua në vitin 1989 nga këngëtari dhe kompozitori serb, Lubomir Manasijeviq.

Sipas rrëfimit të autorit për gazetën serbe "Večernje novosti", kënga u frymëzua nga përjetimet e tij gjatë shënimit të 600-vjetorit të Betejës së Kosovës, në Manastirin e Graçanicës, në qershor të vitit 1989.

Teksti ndërthur referenca ndaj historisë mesjetare dhe trashëgimisë fetare serbe, me pretendime për përkatësinë territoriale të Kosovës.

Në një nga vargjet thuhet: "Ne damo te Kosovo" - "Nuk të japim, Kosovë", ndërsa në një tjetër Kosova paraqitet si tokë që u ka takuar gjithmonë serbëve dhe është trashëguar nga të parët.

E përshkruar si patriotike në mediat serbe, kënga përmban kështu edhe mesazhe nacionaliste që kundërshtojnë heqjen dorë nga Kosova.

Ajo u krijua në kohën e rritjes së nacionalizmit serb nën udhëheqjen e Sllobodan Millosheviqit.

Në vitin 1989, autoritetet serbe kufizuan në mënyrë drastike autonominë e Kosovës, duke përshkallëzuar represionin politik dhe institucional ndaj shqiptarëve.

Një dekadë më vonë, Kosova u përfshi në luftën e viteve 1998-1999.

Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008, por Serbia vazhdon të mos e njohë atë.

Reagimet nga Kosova dhe Parlamenti Evropian

Kryenegociatori i Kosovës me Bashkimin Evropian, Jeton Zulfaj, e kritikoi interpretimin e melodisë, duke e lidhur përmbajtjen e këngës me periudhën kur regjimi i Sllobodan Millosheviqit po kufizonte të drejtat e shqiptarëve të Kosovës.

Ai kërkoi shpjegime nga Komisioni Evropian si për përzgjedhjen e këngës, ashtu edhe për mungesën e një ftese për përfaqësuesit institucionalë të Kosovës në Forum.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, tha se intepretimi i melodisë në fjalë është thellësisht shqetësues dhe shtoi se mesazhet e tilla bien ndesh me parimet e paqes, respektimit të sovranitetit të shteteve.

Edhe ambasadori i Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami, e cilësoi si të papranueshme përfshirjen e kësaj kënge në një aktivitet kushtuar zgjerimit evropian dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Sipas tij, kënga përmban pretendime politike mbi territorin e Kosovës dhe interpretimi i saj nuk mund të trajtohet thjesht si shkëmbim kulturor.

Bajrami kërkoi nga Komisioni Evropian dhe komisionerja për Zgjerim, Kos, të sqarojnë se kush e kishte përzgjedhur dhe miratuar repertorin muzikor.

Ish-ministri i punëve të Jashtme, deputeti, Enver Hoxhaj, ka theksuar se Kosova e ka vendin në tryezën e zgjerimit të Bashkimit Evropian, por nacionalizmi serb nuk e ka vendin në skenën e tij. "Në hapje të Forumit të Zgjerimit në Bruksel u interpretua melodia e një kënge nacionaliste serbe që mohon shtetësinë e Kosovës. Kjo është më shumë se skandaloze. Pasi Komisionerja Evropiane për Zgjerim, Marta Kos po lobon që udhëheqja e UÇK-së në Hagë të dënohen, duke bërë kudo presion kundër Ligjit për Gjykatën Speciale, tani në forumin që ajo e udhëheq po lëshohen këngë nacionaliste me pretendime territoriale ndaj vendit tonë. Pas verdiktit të padrejtë ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit në Hagë, e kam thënë qartë se nuk do të heshtim kur vihet në pikëpyetje liria dhe pavarësia e Kosovës. Këtë ua kam thënë partnerëve tanë evropianë atëherë dhe ua them edhe sot. Bashkimi Evropian e njeh mirë historinë e Kosovës dhe e di çfarë përfaqëson për ne një këngë që shpreh pretendime territoriale ndaj vendit tonë", ka shkruar Hoxhaj në "Facebook".

Edhe kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka thënë se të lejosh këngën nacionaliste serbe në hapjen e Forumit të Zgjerimit të BE-së, nën organizimin e Komisionit Evropian dhe Marta Kos, është fyerje e rëndë ndaj shtetit tonë. "Brukseli duhet të japë sqarim për këtë lëshim", ka shkruar Gjini në "Facebook".

Kritikave iu bashkua edhe raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras, i cili tha se incidenti ishte ose një provokim i qëllimshëm, ose pasojë e mosdijes së organizatorëve.

Sipas Terrasit, interpretimi i një kënge që përmban pretendime mbi sovranitetin e Kosovës në një aktivitet evropian për zgjerimin, ishte i papërshtatshëm dhe kërkon shpjegim nga Komisioni Evropian.

Emini: Përzgjedhja e këngës serbe nuk duket të ketë qenë rastësi

Ekspertja për çështje evropiane, Donika Emini, e cila ishte e pranishme në koncertin hapës të Forumit të Zgjerimit në Bruksel, nuk beson se përzgjedhja e melodisë së këngës serbe për Kosovën ishte rezultat i pakujdesisë.

Në një prononcim për Radion Evropa e Lirë, ajo tha se organizatorët duhej të kishin treguar më shumë kujdes ndaj ndjeshmërive historike dhe politike të rajonit. "Nuk mendoj që është prej pakujdesisë", tha Emini, duke theksuar se problemi nuk qëndron te gjuha serbe e këngës, por te pretendimet territoriale ndaj Kosovës që përmban teksti i saj.

Ajo kritikoi edhe faktin që komisionarja evropiane për Zgjerim, Kos, ua atribuoi përzgjedhjen e këngës muzikantëve, duke theksuar se përgjegjësia për repertorin nuk mund të shmanget në këtë mënyrë.

Emini tha se incidenti ngre shqetësime më të gjera për qasjen e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, veçanërisht në një kohë kur të dyja palët po përpiqen t'i riparojnë marrëdhëniet pas tensioneve të viteve të fundit. "Ndikimi është shumë i madh", tha ajo, duke paralajmëruar se ngjarja mund të ndikojë negativisht jo vetëm në dialogun Kosovë-Serbi, por edhe në atmosferën e përgjithshme të marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Brukselit.

Kosova pa përfaqësues institucionalë në Forum

Polemika për koncertin nxori në pah edhe një çështje tjetër: mungesën e përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës në Forumin e Zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Edicioni i dytë i Forumit, që zhvillohet më 15 dhe 16 nëntor në Bruksel, mbledh udhëheqës evropianë, përfaqësues të vendeve që synojnë anëtarësimin, ekspertë dhe organizata të shoqërisë civile.

Në programin e tij janë përfshirë presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, komisionarja Marta Kos, presidenti i Finlandës, Alexander Stubb, si dhe përfaqësues nga vende të ndryshme të procesit të zgjerimit.

Kryenegociatori i Kosovës me BE-në, Zulfaj, kritikoi mungesën e një ftese për përfaqësuesit institucionalë të Kosovës, por Kos e kundërshtoi pretendimin se Kosova nuk ishte ftuar në Forum. "Nuk është e saktë që përfaqësuesit e Kosovës nuk janë ftuar", tha ajo, duke theksuar se në aktivitet marrin pjesë persona nga të gjitha vendet kandidate dhe kandidate potenciale.

Megjithatë, Kos konfirmoi se pesë vende kandidate marrin pjesë me përfaqësues të qeverive të tyre, ndërsa nga Kosova në diskutime merr pjesë ekspertja e shoqërisë civile, Donika Emini.

Komisionerja nuk sqaroi nëse ftesa u ishin dërguar edhe institucioneve të Kosovës dhe, nëse jo, përse ato nuk ishin përfshirë në të njëjtën mënyrë si qeveritë e vendeve të tjera.

Kosova aplikoi për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022, por kërkesa e saj ende nuk ka kaluar në fazën që do t'i hapte rrugë marrjes së statusit të vendit kandidat.

Pesë nga 27 vendet anëtare të BE-së nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, ndërsa normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë mbetet një nga çështjet kryesore në rrugën e saj evropiane.

BE-ja ndërmjetëson dialogun mes Kosovës dhe Serbisë dhe u kërkon të dyja palëve të zbatojnë marrëveshjet e arritura për normalizimin e marrëdhënieve.

"Në këtë frymë, ne vazhdojmë ta mbështesim Kosovën në rrugën e saj evropiane", tha Kos.



KOSOVA NDALON TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE ME KOMPANI SERBE, SHPALL MASA EMERGJENTE PËR 60 DITË

Qeveria e Kosovës e ka ndaluar tregtimin e energjisë elektrike me kompani serbe të energjisë, për shkak të, siç tha, vendimit të Serbisë për t'i mbajtur të bllokuara linjat ndërkufitare për tregtim. Duke folur në një mbledhje të kabinetit të tij qeveritar të hënën, kryeministri Albin Kurti tha se Kosova po vendos kundërmasa ndaj Serbisë në fushën e energjisë, sepse "gjendja do të përshkallëzohet në të ardhmen, nëse nuk ka reflektim" nga shteti fqinj

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar të hënën tri vendime që lidhen me sektorin e energjisë elektrike, përfshirë ndalimin e tregtimit të energjisë me ndërmarrjet e lidhura me Serbinë dhe shpalljen e masave emergjente për furnizimin me energji.

Sipas vendimit të miratuar, ndalohet blerja, shitja, importi dhe eksporti i energjisë elektrike nga ndërmarrjet e identifikuara si të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me Serbinë, përfshirë edhe tregtimin përmes tranzitit apo rishitjes në shtete të treta.

Për zbatimin e këtij vendimi, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) është obliguar që, brenda afatit ligjor, të identifikojë ndërmarrjet që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike dhe që kanë pronësi, ndërmarrje amë apo lidhje me persona fizikë ose juridikë të regjistruar në Serbi.

Megjithatë, vendimi parasheh përjashtime për transaksionet dhe aktivitetet që burojnë nga Marrëveshja e Brukselit për Energjinë e vitit 2013 dhe dokumentet e tjera përkatëse të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Në të njëjtën mbledhje, Qeveria ka miratuar edhe vendimin për shpalljen e masave emergjente për furnizimin me energji elektrike, të cilat do të jenë në fuqi për 60 ditë nga hyrja në fuqi e vendimit.

Po ashtu, është miratuar vendimi për vendosjen e obligimit të shërbimit publik ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), për sigurimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmisionit.

Ky obligim synon të adresojë mungesën e prodhimit të planifikuar të energjisë elektrike nga njësia B1 e Termocentralit "Kosova B".

Duke folur në një mbledhje të kabinetit të tij qeveritar të hënën, kryeministri Albin Kurti tha se Kosova po vendos kundërmasa ndaj Serbisë në fushën e energjisë, sepse "gjendja do të përshkallëzohet në të ardhmen, nëse nuk ka reflektim" nga shteti fqinj.

Kurti tha se vendimi vjen pasi Serbia nuk e zbatoi kërkesën e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë për t'i zhbllokuar linjat e interkoneksionit ndërkufitar më 1 korrik. "Janë bërë katër muaj e gjysmë që nuk është zbatuar ky vendim i Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë, ne e kemi bërë edhe një përpjekje tjetër që përmes Bashkimit Evropian të kemi një zgjidhje të kësaj çështje", tha Kurti.

Serbia, përmes operatorit të sistemit të transmetimit të saj, EMS, e ka pamundësuar shfrytëzimin komercial të dy linjave të interkoneksionit 400 kilovoltsh që nga viti 2020, sipas zëvendësministrit të Tregtisë të Kosovës, Fatban Bunjaku.

Kryeministri tha se ky vendim nuk vlen për furnizuesin e themeluar në bazë të Marrëveshjes së Brukselit për energji mes dy vendeve, Elektrosever.

Elektrosever është një kompani në pronësi të kompanisë energjetike nga Serbia, Elektroprivreda Srbije (EPS), e cila është e regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës.

Kjo kompani furnizon me energji elektrike konsumatorët në katër komunat me shumicë në veri të Kosovës: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Kurti paralajmëroi se Kosova do ta shqyrtojë "përshkallëzimin e masave" që do të mund ta preknin edhe Elektroseverin dhe zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit për energji, nëse Serbia nuk zhbllokon linjat ndërkufitare në të ardhmen.

Ky vendim vjen në një kohë kur pushteti në Serbi është ndryshuar dhe Lista Studentore, e cila e rrëzoi nga pushteti pas 14 vjetësh partinë e ish-presidentit Aleksandar Vuçiq, pritet ta bëjë qeverinë e re serbe së shpejti.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, pas mbledhjes së qeverisë, ka mbajtur një konference për media, në të cilën ka shpjeguar se bllokimi i linjave të transmetimit nga Serbia, që nga 14 dhjetori i vitit 2020, i ka shkaktuar Kosovës dëme të konsiderueshme financiare dhe ka rrezikuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike. "Që nga data 14 dhjetor i vitit 2020, kur Kosova është e pavarësuar nga blloku energjetik me Serbinë dhe funksionon si bllok rregullues i pavarur në kuadër të bllokut Shqipëri-Kosovë, Serbia ka bllokuar linjat e transmetimit me Kosovën për alokim komercial dhe tregtim. Kjo ka shkaktuar dëme të konsiderueshme për Kosovën, duke përfshirë këtu dëmet financiare, mirëpo edhe rrezikun e furnizimit me energji elektrike në disa raste", tha Rizvanolli.

Ministrja potencoi se kërkesa e Kosovës për lirimin e linjave nuk lidhet me dëshirën për të importuar energji elektrike nga Serbia, por me mundësinë e shfrytëzimit të tyre për tranzit të energjisë nga shtetet e tjera. "Ne nuk e duam lirimin e linjave me Serbinë për shkak se dëshirojmë të importojmë energji elektrike nga Serbia, mirëpo bllokimi i linjave nga Serbia do të thotë që ato janë të pashfrytëzueshme për ne për tranzit. Kjo do të thotë që energjia elektrike nga shtetet e tjera nuk mund të vijë përmes këtyre linjave, duke përfshirë këtu edhe faktin që vështirësohet shumë ose pamundësohet sjellja e energjisë nga bursa e HUPX-it, që është një ndër bursat më likuide të rajonit", tha Rizvanolli.

Rizvanolli ka bërë të ditur se pas ankesës zyrtare të KOSTT-it në vitin 2021 në Komunitetin e Energjisë, Këshilli i Ministrave i këtij komuniteti, në dhjetor të vitit 2025, ka konstatuar shkeljen e traktatit nga ana e Serbisë dhe e ka obliguar atë që deri më 1 korrik 2026 t'i lirojë linjat për tregtim.

Megjithatë, sipas saj, Serbia nuk e ka zbatuar këtë vendim deri në afatin e përcaktuar.

→

KURTI RAPORTON PËR VIZITAT NË PARIS DHE DUBLIN: ZHVILLUAM MBI 30 TAKIME ME LIDERË NDËRKOMBËTARË

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e Qeverisë ka raportuar të hënën për vizitat zyrtare në Paris dhe Dublin, ku ka marrë pjesë në Forumin e Paqes dhe Samitin e Komunitetit Politik Evropian (EPC).

Kurti ka bërë të ditur se gjatë këtyre vizitave janë zhvilluar më shumë se 30 takime, pritje, bashkëbisedime dhe aktivitete të ndryshme, përfshirë tetë takime me presidentë dhe kryeministra, si dhe me sekretarët e përgjithshëm të NATO-s dhe Këshillit të Evropës.

Në Paris, kryeministri ka zhvilluar takim bilateral me presidentin francez, Emmanuel Macron, si dhe është pritur nga presidenti i Senatit, Gérard Larcher.

Ai ka takuar edhe kryeministrin e Armenisë, Nikol Pashinyan, dhe kryetarin e Parisit, Emmanuel Grégoire.

Ndërkaq, në Dublin, Kurti ka zhvilluar takime me kryeministrin irlandez, Micheál Martin, ministren e Jashtme, Helen McEntee, si dhe liderë të tjerë ndërkombëtarë, përfshirë kryeministrin britanik, Andy Burnham, kryeministrin kanadez, Mark Carney, dhe sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte.

Gjatë adresimit të tij, Kurti ka theksuar se në të gjitha takimet është riafirmuar përkushtimi i Kosovës ndaj të ardhmes euroatlantike.

Ai ka nënvizuar rëndësinë e avancimit të procesit të integrimit evropian, duke kërkuar që Këshilli i BE-së të kërkojë mendim nga Komisioni Evropian për aplikimin e Kosovës për anëtarësim, të dorëzuar më 15 dhjetor 2022.

Po ashtu, Kurti ka ritheksuar se anëtarësimi në NATO mbetet prioritet strategjik për Kosovën, ndërsa anëtarësimin në Këshillin e Evropës e ka vlerësuar të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve.



QEVERIA MIRATON TRI PROJEKTLIGJE PËR NJOHJEN E VENDIMEVE GJYQËSORE DHE LUFTIMIN E KRIMEVE NDËRKOMBËTARE

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur të hënën, ka miratuar tri projektligje për ratifikimin e konventave ndërkombëtare të rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, rritjen e sigurisë juridike dhe avancimin e mekanizmave për luftimin e krimeve më të rënda ndërkombëtare.



Projektligji i parë ka të bëjë me ratifikimin e Konventës së Hagës për Marrëveshjen për Zgjedhjen e Gjykatës (2005), e cila garanton respektimin e marrëveshjeve ndërmjet palëve për përcaktimin e gjykatës kompetente në rast të kontesteve në marrëdhëniet ndërkombëtare civile dhe tregtare.

Për Republikën e Kosovës, ratifikimi i saj ka rëndësi të veçantë për krijimin e një mjedisi juridik më të besueshëm dhe të parashikueshëm për bizneset dhe investitorët e huaj, si dhe për forcimin e pozitës ndërkombëtare të vendit përmes anëtarësimit në instrumentet kryesore të Hagës.

Projektligji i dytë parasheh ratifikimin e Konventës së Ljublanës/Hagës për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Hetimin dhe Ndjekjen Penale të Krimit të Gjenocidit, Krimeve kundër Njerëzimit, Krimeve të Luftës dhe Krimeve të tjera Ndërkombëtare, e cila krijon një kornizë të strukturuar për bashkëpunimin ndërmjet shteteve në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve më të rënda ndërkombëtare.

Ky Projektligj, përfshinë mekanizmat për ndihmë të ndërsjellë juridike, ekstradim dhe shkëmbim të informacionit, si dhe përcakton garanci për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave të viktimave.

Po ashtu, ky Projektligj mbështet përpjekjet për luftimin e pandëshkueshmërisë dhe kontribuon në forcimin e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë dhe organeve të zbatimit të ligjit, përmes bashkëpunimit më të strukturuar me shtetet e tjera.

Ndërkaq, projektligji i tretë ka të bëjë me ratifikimin e Konventës së Hagës për Aktgjykimet (2019), për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore të Huaja në Çështjet Civile ose Tregtare, i cili përcakton rregulla të përbashkëta për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare.

Aderimi i Republikës së Kosovës në këtë instrument ndërkombëtar pritet të rrisë sigurinë juridike, të lehtësojë marrëdhëniet tregtare ndërkombëtare dhe investimet e huaja, si dhe të forcojë bashkëpunimin gjyqësor ndërmjet shteteve.

Ratifikimi i këtyre tri konventave përfaqëson një hap të rëndësishëm në zgjerimin e angazhimit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës në fushën e drejtësisë, forcimin e sundimit të ligjit dhe krijimin e një sistemi juridik më të sigurt e më të besueshëm, në përputhje me standardet dhe instrumentet ndërkombëtare.

Ministrja ka treguar se më 11 nëntor i është drejtuar ministres së Ndërmarrësisë, Tregtisë, Industrisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, me kërkesën që të shqyrtohej mundësia e marrjes së masave tregtare si kundërmasa ndaj Serbisë për bllokimin e linjave.

Ajo ka falënderuar Kusari-Lilën për reagimin e shpejtë, duke theksuar se vendimi i sotëm është propozuar pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar, përfshirë raportet e ZRRE-së dhe KOSTT-it.

Opozita, Qeverisë: Paskan qenë të vërteta pazaret me rrymën e Serbisë dhe mafian energjetike

Në lidhje me ketë vendim të qeverisë, ka pasur reagime edhe nga deputet të pozitës dhe opozitës.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Nezir Kraki, ka kritikuar Qeverinë e udhëhequr nga kjo parti për çështjen e krizës energjetike. "D.m.th paskemi ble rrymë nga Serbia dhe prapë kemi mbetur pa rrymë. Dy herë dështim. Dy herë gabim. A mos ka ardhur koha për të filluar me u mësu me përgjegjësinë morale si koncept edhe në politiken e Kosovës? Sepse asnjë fajtor, asnjë përgjegjës pavarësisht çka ndodhë në këtë vend, seriozisht nuk shkon", ka shkruar ai në "Facebook".

Deputeti i PDK-së, Arben Mustafa, ka thënë se për të gjithë ata që mohonin se Kosova po blen energji elektrike nga Serbia, sot vetë Qeveria e Kosovës dëshmoi se 'Po'. "Pra, ishte e vërtetë se miliona euro të qytetarëve të Kosovës kanë përfunduar në Serbi. Tash kanë vendosur ta ndalin këtë praktikë, të cilën deri dje e mohonin se ekzistonte. Por, ky vendim nuk e amniston Qeverinë nga përgjegjësia për t'u dhënë qytetarëve përgjigje për pyetjet që vazhdojnë të mbeten pa përgjigje.

Me çka do të përballen qytetarët këtë dimër, të cilin vetë Qeveria po e paralajmëron si të vështirë? A do të ketë reduktime të energjisë elektrike dhe sa të gjata do të jenë ato? A do të shtrenjtohet edhe më shumë energjia elektrike? Cili është plani konkret i Qeverisë për ta përballuar dimrin, kur as kapacitetet ekzistuese prodhuese të KEK-ut nuk janë në dispozicion me kapacitet të plotë?", ka shkruar në "Facebook" Mustafa.

Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, duke reaguar për këtë vendim të qeverisë, ka shtruar një pyetje. "A mund të ndalet diçka, e cila sipas shumë zyrtarëve të Qeverisë, nuk ka ekzistuar? Ajo që ndalet, duhet të ekzistojë".

Hoti ka thënë se nëse dikush mohon një gjë që ekziston, atëherë ose nuk di çfarë po ndodh, ose e mohon për arsye të dyshimta që së shpejti do të zbardhen.

Deputeti i Aleancës, Burim Ramadani, ka thënë se ky vendim i Qeverisë për të ndaluar tregtimin e energjisë me kompanitë serbe është dyfish i dyshimtë. "E para, po e pranojnë vetë me gojën e tyre se



krejt çka kemi thënë tash e sa kohë për pazaret me rrymën e Serbisë dhe mafian energjetike ka qenë e vërtetë. E dyta, po e përdorin këtë si perde tymi për t'i arsyetuar ndaljet e rrymës dhe reduktimet që po na presin këtë dimër. Për një mandat të tërë e lanë Kosovën pa asnjë zgjidhje të qëndrueshme energjetike, ndërsa buxhetit të shtetit i u zhvaten miliona euro në kontrata e tregti të dyshimta", ka shkruar Ramadani në "Facebook".

Ai ka shtuar se sot, në momentin kur skandalet po u shpërthejnë në çdo sektor dhe vendi po rrezikon reduktime të ashpra të energjisë elektrike, po tentojnë ta fshehin dështimin e tyre në emër të "patriotizmit". "Një vendim i vonuar nuk mund ta amnistojë koston e rëndë financiare që u është faturuar qytetarëve. Prandaj, duhet hetim i menjëhershëm dhe i paanshëm për të gjitha ato miliona të shpenzuara deri më sot", ka shkruar ai.

Kosova shpreh përkushtimin për bashkëpunim rajonal në fushën e migracionit në kuadër të Procesit të Pragës

Prishtinë, 16 nëntor - Një delegacion i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga Jeta Tela-Shema, shefe e kabinetit të ministrit, mori pjesë në takimin e Zyrtarëve të Lartë të Procesit të Pragës, të mbajtur më 10 - 11 nëntor 2026, në Pragë të Republikës së Çekisë.

Ky takim i paraprin Konferencës së Pestë Ministrore të Procesit të Pragës, e cila do të mbahet në Vilnius të Lituanisë.

Gjatë takimit, delegacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme prezantoi arritjet e Republikës së Kosovës në avancimet që janë bërë në fushën e migracionit, duke e vënë theksin në forcimin e koordinimit ndërinstitucional përmes Autoritetit Qeveritar për Migracion, funksionalizimin e Sistemit të Identifikimit Biometrik në pikat kufitare, avancimin e kapaciteteve për pritjen dhe mbrojtjen e migrantëve, si dhe zhvillimin e Sistemit të Integruar për Menaxhimin e Informatave për Migracionit.

Kosova konfirmon mbështetjen për Planin e Veprimit 2028 - 2032, duke shprehur gatishmërinë për të kontribuar aktivisht në zbatimin e prioriteteve të përbashkëta.



Pjesëmarrja e Kosovës në këtë takim dëshmon përkushtimin e saj për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, avancimin e politikave të bazuara në të dhëna dhe kontributin aktiv në zhvillimin e Procesit të Pragës.

THAÇI DHE KATËR TË TJERËT PRESIN AKTGJYKIMIN TË MARTËN

Prishtinë, 16 nëntor - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, do të përballet të martën me një tjetër aktgjykim në Hagë, në kuadër të një procesi gjyqësor ku mbrojtja i ka kundërshtuar akuzat, duke i cilësuar ato si të paprovuara dhe të mbështetura në interpretime juridikisht të gabuara.

Gjykatësi Christopher Gosnell ka caktuar 17 nëntorin, në orën 10:00, për shpalljen e vendimit, ndërsa ka urdhëruar praninë e të pesë të akuzuarve në seancë.

Përveç Thaçit, aktgjykimin do ta dëgjojnë edhe ish-drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Bashkim Smakaj, ish-kryetari i Malishevës, Isni Kilaj, ish-ministri Hajredin Kuçi dhe Fadil Fazliu.

Thelbi i përplasjes mes Prokurorisë dhe mbrojtjes lidhet me bisedat e regjistruara gjatë vizitave në paraburgim, përkatësisht me përmbajtjen e tyre, personat që kanë marrë pjesë në to dhe atë që këto materiale mund të dëshmojnë.

Prokuroria i konsideron regjistrimet si prova të përpjekjeve për të ndërhyrë te dëshmitarët. Në anën tjetër, avokatët e Thaçit kanë kundërshtuar si interpretimin e këtyre bisedave, ashtu edhe besueshmërinë e transkripteve të tyre.

Në parashtrimet përfundimtare, mbrojtja ka pretenduar se hetimet nuk kanë arritur të sigurojnë prova që dëshmojnë kontakte të papërshtatshme me dëshmitarët në emër të ish-presidentit.



NË STRUGË U PËRURUA ROMANI "REVOLTA E SYZIFIT" I BARDHYL MAHMUTIT

Strugë, 16 nëntor - Në një atmosferë të veçantë kulturore dhe me interesim të shumë pjesëmarrësve, në Strugë u përurua romani "Revolta e Syzifit" i autorit Bardhyl Mahmuti.

Përurimi u organizua nga Qendra Gjenocidi në Kosovë "Plagë e hapur", në bashkëpunim me Komunën e Strugës dhe Hotelin "Ëmbla".

Për romanin dhe rëndësinë e tij letrare e tematike folën autori Bardhyl Mahmuti, kryepersonazhi i romanit, Fadil Muqolli, kryetari i Komunës së Strugës, Mendi Qyra, si dhe kryetari i Shoqatës së ish-të Burgosurve Politikë për Maqedoni të Veriut, Shpëtim Pollozhani.

Pjesëmarrja e vet kryepersonazhit të romanit, Fadil Muqollit, i dha këtij përurimi një dimension të veçantë, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet rrëfimit letrar dhe përvojës njerëzore që qëndron në themel të tij.

Përmes këtij takimi, Struga u bë



një tjetër pikëtakim i letërsisë, kujtesës dhe reflektimit mbi ngjarjet dhe përvojat që kanë lënë gjurmë në historinë tonë kolektive.

Përurimi i romanit "Revolta e Syzifit" dëshmoi edhe një herë rëndësinë e librit si hapësirë e rrëfimit, e kujtesës dhe e komunikimit me lexuesin, si dhe rolin që kanë veprimtaritë e tilla në gjallërimin e jetës kulturore shqiptare.

Autori Bardhyl Mahmuti tha se "dhimbjen ne shqiptarët e kemi të përbashkët dhe atë duhet ta kujtojmë çdoherë dhe duhet t'i nderojmë sakrificat e të gjitha familjeve dhe çlirimtarëve".

Kryepersonazhi i romanit të tij, Fadil Muqolli, i falënderoi të pranishmit dhe organizatorët për nderin që i bënë sonte dhe porositi që duhet të luftojmë me mish e shpirt kundër harresës.

Kryetari i Strugës, zoti Qyra, tha se qyteti që udhëheq ai vazhdimisht po merr tiparet e një qyteti kulturor dhe letrar dhe se ndihet i nderuar që këtë herë po bashkëveprojnë me Qendrën "Plagë e hapur" për të përuruar romanin e Bardhyl Mahmutit dhe se veprimtari të tilla do të organizojnë vazhdimisht.

Ndërkaq veprimtari Pollozhani tha se kjo vepër letrare e Bardhylit sa më parë duhet të futet në programet e shkollave si lektyrë.

Para fillimit të përurimit, për pjesëmarrësit u shfaq një dokumentar për masakrën në Poklek të Vjetër dhe u dëgjua kënga "Ne nuk harrojmë", kushtuar të gjitha viktimave të rëna gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Avokati i Popullit hap zyrë në veri, qytetarët e katër komunave mund të paraqesin ankesat

Prishtinë, 16 nëntor - Institucioni i Avokatit të Popullit ka hapur të hënën zyrën e tij në Mitrovicë të Veriut, me qëllim të lehtësimit të qasjes së qytetarëve në këtë institucion dhe ofrimit të mbështetjes për të gjithë banorët e katër komunave veriore.

Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka thënë se ideja për hapjen e kësaj zyre ka ardhur si rezultat i kërkesave të vazhdueshme të qytetarëve, të cilët gjatë takimeve me përfaqësues të institucionit kanë shprehur shqetësimin për vështirësitë në qasjen te shërbimet e Avokatit të Popullit.

Ai ka bërë me dije se zyra është e gatshme dhe do të jetë funksionale për pranimin e ankesave dhe mbajtjen e dyerve të hapura për qytetarët.



Kryeprokurori dhe kryetari i Supremes diskutojnë ashpërsimin e dënimeve për veprat kundër rendit kushtetues dhe korrupsionin



PRISHTINË, 16 NËNTOR - Kryeprokurori i Shtetit, Zejnulla Gashi, dhe zëvendëskryeprokurori Bahri Hyseni, kanë pritur në takim kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Fejzullah Rexhepi, dhe gjyqtarin Agim Maliqi.
Sipas njoftimit të Prokurorisë së Shtetit, temë qendrore e takimit ishte nevoja për ashpërsimin e politikës ndëshkimore për veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, si dhe për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë.
Gjatë takimit, përfaqësuesit e të dy institucioneve konfirmuan përkushtimin për avancimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore.
Ky bashkëpunim synon forcimin e sundimit të ligjit dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

KËSHILLI PROKURORIAL DHE AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT DISKUTOJNË FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 16 NËNTOR - Anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Visar Krasniqi, mori pjesë sot në tryezën e organizuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me temën "Lansimi i Kornizës Zhvillimore Strategjike të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit 2026 - 2030".
Në këtë tryezë morën pjesë edhe drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, zëvendëskryesuesja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Afërdita Bytyqi, përfaqësuesi i shoqërisë civile, Ismet Kryeziu, si dhe përfaqësuesi i Administratës Tatimore të Kosovës, Isen Lipovica. Gjatë tryezës u diskutuan prioritetet strategjike dhe rëndësia e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.
Gjatë fjalës së tij, anëtari i KPK-së, Visar Krasniqi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve përgjegjëse në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Ai vuri në pah rolin e rëndësishëm të Sistemit Prokurorial në trajtimin e rasteve të korrupsionit, duke theksuar se rezultatet në këtë fushë varen nga bashkërendimi i veprimeve institucionale, shkëmbimi i informacioneve dhe forcimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional.
Me këtë rast, Krasniqi theksoi se Kryeprokurori i Shtetit ka themeluar dy mekanizma të rëndësishëm brenda Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit: Mekanizmin Mbikëqyrës të Punës së Prokurorit të Shtetit dhe Mekanizmin e Mbrojtjes së Integritetit të Prokurorit të Shtetit, të cilët kontribuojnë në forcimin e mbikëqyrjes institucionale dhe ruajtjen e integritetit të institucionit.
Po ashtu, ai ngriti çështjen e rishikimit të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me qëllim të avancimit të mëtejmë të bashkëpunimit dhe përcaktimit të formave më efektive të koordinimit ndërmjet dy institucioneve.
Gjatë diskutimit, përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave pjesëmarrëse shprehën qëndrimet dhe vlerësimet e tyre lidhur me Kornizën Zhvillimore Strategjike 2026 - 2030, duke theksuar rëndësinë e angazhimit të përbashkët, bashkëpunimit më të ngushtë ndërinstitucional dhe koordinimit të veprimeve për zbatimin e objektivave strategjike në funksion të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

PRESIDENTJA NË 10-VJETORIN E NALT-it: ANËTARËSIMI NË NATO MBETET SYNIMI STRATEGJIK I KOSOVËS



PRISHTINË, 16 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula, mori pjesë në ceremoninë e dhjetëvjetorit të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s në Kosovë (NALT).
Me këtë rast, presidentja Shiroka-Pula theksoi se NATO ka një vend të veçantë në historinë e Kosovës, duke rikujtuar kontributin e saj vendimtar në çlirimin e vendit më 1999, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye. Ajo shprehu mirënjohjen e përhershme për këtë kontribut historik dhe nënvizoi se NATO mbetet simbol i lirisë dhe sigurisë së Kosovës.
Presidentja Shiroka-Pula ritheksoi se anëtarësimi në NATO është ndër synimet strategjike të Kosovës, ndërsa ambicia e vendit është zhvillimi i mëtejmë i Forcës së Sigurisë së Kosovës, në mënyrë që ushtarët e saj një ditë të qëndrojnë krah për krah me ushtarët e vendeve aleate, duke kontribuar në sigurinë dhe paqen e përbashkët.
Ajo vlerësoi lart kontributin dhjetëvjeçar të NALT-it në mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes, FSK-së dhe Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, përmes zhvillimit të kapaciteteve profesionale, strukturave institucionale, mbikëqyrjes demokratike dhe menaxhimit të emergjencave.
Në përmbyllje, presidentja Shiroka-Pula falënderoi gjeneralin Borghoff dhe të gjithë pjesëtarët e NALT-it për përkushtimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, duke i uruar për dhjetëvjetorin e themelimit të këtij ekipi

Kryetari i Gjykatës Administrative kërkon nga gjyqtarët më shumë efikasitet në zgjidhjen e lëndëve



Prishtinë, 16 nëntor- Kryetari i Gjykatës Administrative, Kreshnik Kaçiu, zhvilloi të hënën kolegjiumin e radhës me gjyqtarët e katër departamenteve të gjykatës: Departamentit Fiskal; për Konteste të Punës; për Skemat Sociale dhe Pensionale të financuara nga shteti; dhe Departamentit të Përgjithshëm, ku temë e vetme e rendit të ditës ishte efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve.
Gjatë këtij kolegjiumi, u konstatua se efikasiteti në zgjidhjen e lëndëve në tre mujorin e tretë të vitit 2026, nuk ka qenë i kënaqshëm. Prandaj, kryetari Kaçiu, kërkoi nga të gjithë gjyqtarët angazhim maksimal dhe përkushtim të vazhdueshëm në rritjen e efikasitetit në trajtimin dhe zgjidhjen e lëndëve si dhe ngritje substanciale të normës së zgjidhjes së lëndëve.
Në kolegjium, një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe mundësisë së vendosjes për lëndët pa mbajtjen e seancave gjyqësore, në rastet kur plotësohen kushtet ligjore për një procedurë të tillë.
Në përmbyllje të takimit, kryetari Kaçiu ritheksoi rëndësinë e angazhimit individual dhe përgjegjësisë profesionale të secilit gjyqtar, në arritjen e rezultateve konkrete në zgjidhjen e lëndëve, me synim ofrimin e drejtësisë në kohë të arsyeshme dhe rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

Kosova grumbulloi 477 mijë tonë mbeturina gjatë vitit 2025, rritet sasia për kokë banori

Prishtinë, 16 nëntor - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Mbeturinave Komunale për vitin 2025, sipas të cilave gjatë këtij viti në Kosovë janë grumbulluar gjithsej 477 mijë tonë mbeturina komunale.
Sipas ASK-së, kjo paraqet një rritje prej 1,92 për qind krahasuar me vitin 2024.
Të dhënat tregojnë se mesatarja e mbeturinave të grumbulluara në nivel vendi ishte 301 kilogramë për banor në vit, apo 0,83 kilogramë në ditë.
Sa i përket shpërndarjes rajonale, Prishtina prin me 143 mijë tonë mbeturina, që përbëjnë 30 për qind të totalit në nivel vendi. Mesatarja në këtë rajon ishte 0,76 kilogramë për banor në ditë.
Pas Prishtinës renditet Prizreni me 91 mijë tonë ose 19,1 për qind të totalit, i ndjekur nga Mitrovica me 66 mijë tonë ose 13,8 për qind.
Ndërkaq, Ferizaj ka regjistruar sasinë më të ulët, me 40 mijë tonë mbeturina komunale, që përbëjnë 8,4 për qind të totalit.
ASK-ja vlerëson se këto të dhëna paraqesin një burim të rëndësishëm statistikor për vlerësimin e gjendjes së sektorit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.



AKB-ja: PROTESTAT DHE TENSIONET NË SHQIPËRI PO FRENOJNË INVESTIMET KOSOVARE DHE PO RRISIN PASIGURINË EKONOMIKE



Prishtinë, 16 nëntor - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), si partner institucional shtetëror dhe i organizatave ekonomike dhe shoqërore në Shqipëri, shpreh shqetësimin për klimën e pasigurisë që po krijojnë tensionet dhe protestat e vazhdueshme në Shqipëri.
Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se institucioni që drejton respekton të drejtën demokratike për protestë, por konsideron se përplasjet politike nuk duhet të shndërrohen në pengesë për zhvillimin ekonomik, sigurinë e qytetarëve dhe funksionimin normal të bizneseve.
Ai ka thënë se investitorët nuk investojnë aty ku mungojnë stabiliteti, siguria juridike dhe parashikueshmëria. "AKB-ja vëren se një pjesë e investitorëve kosovarë po tregohen më të rezervuar dhe po ngadalësojnë vendimmarrjen për investime të reja në Shqipëri. Pasiguria politike, tensionet institucionale dhe mungesa e një klime të qëndrueshme ndikojnë drejtpërdrejt në besimin e kapitalit dhe në planet afatgjata të biznesit. Shqipëria nuk duhet të rrezikojë humbjen apo shtyrjen e investimeve për shkak të krizave politike. Pozita dhe opozita duhet ta kuptojnë se ekonomia nuk mund të mbahet peng i interesave partiake. AKB-ja u bën thirrje të gjithë faktorëve politikë dhe institucionalë që, përmes dialogut dhe përgjegjësisë shtetërore, të garantojnë stabilitet politik, siguri juridike dhe një klimë të favorshme për investime. Shqipëria ka nevojë për më pak përplasje politike dhe më shumë investime, prodhim, eksporte dhe punësim. Marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë duhet të forcohen, jo të pengohen nga pasiguria politike. Kapitali nuk pret pafundësisht - ai shkon aty ku gjen siguri, stabilitet dhe perspektivë", është shprehur Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB).

GERXHALIU: INFLACIONI NË KOSOVË NUK E PASQYRON PLOTËSISHT BARRËN EKONOMIKE TË QYTETARËVE

Prishtinë, 16 nëntor - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gerxhaliu, ka ngritur shqetësimin për dallimin ndërmjet inflacionit zyrtar dhe kostos reale të jetesës me të cilën përballen qytetarët në Kosovë.
Në një postim në "Facebook", Gerxhaliu ka theksuar se statistikat e inflacionit mund të jenë matematikisht të sakta, por jo gjithmonë e pasqyrojnë plotësisht realitetin ekonomik të familjeve kosovare.
Ai ka shpjeguar se ndikimi i inflacionit ndryshon varësisht nga të ardhurat dhe struktura e shpenzimeve familjare. Sipas tij, familjet me të ardhura të ulëta shpenzojnë pjesën më të madhe të buxhetit për ushqim, energji, banim dhe transport, prandaj rritja e çmimeve të këtyre produkteve dhe shërbimeve i prek më shumë ato.
Gerxhaliu ka vlerësuar se inflacioni duhet të analizohet jo vetëm përmes përqindjeve zyrtare, por edhe në raport me pagat, pensionet, të ardhurat familjare dhe fuqinë blerëse të qytetarëve.
Në fund, ai ka theksuar se ekonomia nuk matet vetëm me shifra statistikore, por edhe me atë se sa mund të blejë një qytetar me të ardhurat e tij.



Dogana e Kosovës shënon rritje të hyrave prej 5.7 për qind

Prishtinë, 16 nëntor - Dogana e Kosovës ka realizuar të hyra në vlerë prej 1 miliard e 708 milionë euro gjatë periudhës janar - tetor 2026, duke shënuar një rritje prej 5.7% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025.
Në periudhën janar - tetor 2026, të hyrat e realizuara arritën në 1,708,243,582.06 euro, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak ishin 1,615,537,254.62 euro.
Rritje është shënuar në të gjitha kategoritë kryesore të të hyrave: Taksa e Doganës: +6.6%; Taksa e Akcizës: +1.8%; TVSH-ja: +7.8%.
Këto rezultate pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të Doganës së Kosovës në mbledhjen e të hyrave, zbatimin e legjislacionit doganor dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit.



THEMELIMI I TIRANËS SIPAS BOTIMIT ‘‘SHQYPNIJA E ILUSTRUEME’’ (1929)

Marrë nga Shqypnia e Ilustrueme: Historija e Tiranës, fq. 53-59, botuar nga shtypshkronja “Zoja e papërlyeme” në Shkodër më 1929, ribotuar nga “Alsar”, Tiranë, 2020.



Legjendë I. mbi themelimin e Tiranës

Mbasi pamë ashtu për rresht Tiranln moderne, po mundohena me histori me çekë edhè disá sende mbi Tiranën e motshme.

Degrand *), në f. 205, kështu e pershkruen themelimin e Tiranës. [* A. Degrand « Suvenir de la Haute Albanie » - paris, 1901.]

«Mbi naltsi kû ngrehet gjyteti i Tiranës nuk shihej kah vj. 1600 veç nji pyllë e ndo’i kësollë e shkretë. Në Selitë, kahë Jug-perendimi, kishte kullen e vet nji beg i ardhun nga Peqini (Shqypni e Poshtme) qi quhej Selman, e prandej tokët mbi të cillat gjindej pylla quheshin Selmanehe. Në Muleti, n’anë tjetër, nder brigje të lumit Erzen, gjindej kështjelli i nji begut tjetër quejtun Sylejman qi ishte i familjes Barhime në gjini me të famshmin Nesuh Pasha, i njoftun me emnin Konakli dalë në pah per bâmirsí pse bâni me goditë gjatë udhës Ismidit në Bagdad, hâne 9 deri në 10 orë larg njeni prej tjetrit e të gjith nji sojit per kah trajta e randsija: secilli sish kishte tokë, fryti i të cillave prishej per mbajtje të tyne.

Sylejman Begu ishte nieri i gjytetnue e poet me famë. Si shkoj në Stambollë, e qiti rasa me hyë në Pallat të Sulltanit e me i shkrue në vjershë nji lavd qi Padishahi e pelqej e per shperblim e bâni Pashë.

Sylejman Pasha mbasi muer komanden e nji trupi ushtrije qi veprote në Persi, u dá në shêj per trimní nder shum luftime (shikjo historin turqishte të Naim-it) e Sulltani per shperblim i dha dy bishta kali (d. m. th. e bâni gjeneral divizioni). Kúr armata, dimnit, prête operacjonet, aj e kishte zakon me këthye n’atdhé të vet e pylla e bukur e sasija e ujnave i u dukshin mjete letsimi per me themelue nji gjytet e, s’práte tuj e lutë Selman Begun me i a shitë pjesen e tokve të tija. Selmani nuk i u gjegj kurrsesi prandej marrëdhanjet mjes dy bejlerve u bâne t’ashpra e t’egra. Sylejmani i fórt në pozicjon të vet atje në Stambollë, urdhnoj nji ditë të priten landët e pyllës per me ngrehë nji xhami edhè nji furrë (vj. 1605); goditja s’ishte krye endè kúr Selman Begu qi u kishte pri të vetve u rá puntorve edhè rrenoj xhamin. Por s’i ngiati gëzimi pse paditë per sakrilegj nga anmiku i vet kje gjikue per dekë; gjâja e malli i tij kjene shitë e Sylejman Pasha pa të vishtirë mujt me i bâ per vedi e me shti në veprim projektin qi pat nisë. Ndertoj nji shpí e me të nduell afer vedi edhè rrethinat tuj fillue kshtû godin e atij gjyteti qi e quejti Tehran në kujtim të nji fitimit qi kishte bâ në Persí; kjo âsht rrjedha e këtij gjyteti, emni i të cillit pak ka-pak shkoj tuj u shndrrue e u bâ Tiran per Tyrqit e, Tiranë-a per Shqyptarët: qe shkaku me prûe këtû Barhimet e Muletis. Deri këtû Degrand-i.»

Ket legjendë mund t’a njohim të vërtetë deri aty kû Sylejman Pasha themeloj xhamin e furrën rreth të cillave u shtuen ndertesat sa me perbâ nji katund a por gjytet, por, sa per emnin Tiranë se vjen prej fjalës Tehran qi i dha i syprithanuni Pashë, këtë e mohojmë shqimit me dokumenta në dorë. Barleti — qi shkroj librin: De obsidione Scodrensi (Rrethimi i Shkodrës në vj. 1478) e Historin de vita et gestis Skanderbegi Epirotarum Principis (Jeta e trimit e Skanderbegut Princ Epirotas), — në ket librin e mram f. 16 e 17 tuj folë per princat qi muerne pjesë në Kishë të Lezhës në lidhje kundra Tyrkut, thotë se muer pjesë edhè Ndrekë Topija. „Andreae Topiae est amplum imperium inter Tiranam et Epitanum fuit“ ase shqyp: „Viset kû u shtritte sundimi mjeft i hapët i Ndrekë Topís, u gjindshin ndermjet të Tiranës e të Durrsit.“ Tesh, Ndrekë Topija sundote mbi at krahinë qi quhej Tiranë qyshë në vj. 1440 ndërsa Sylejman Pasha mujti në Persí gjytetin Tehran në vj. 1607, prandej, edhè 160 vjet perpara Tirana permendej me ket emen. Na, me mâ shum arsye, besojmë se marrë krahina e Tiranës thirrej kështu qyshë n’at kohë qi Grekët sundojshin mbi Durrës e se n’at krahinë bâheshin kullosët e mbaheshin tufet e mdhá të berreve qi epshin tamel, djathë e tlyen gjytetit të Durrsit. Latinisht Tyros a por turos greqisht, don me thanë tlyen, djathë, etj. prandej prej fjalës tyros erdh fjala Tiranë — vend djathit. Edhè afer Lodi-t n’Italí âsht nji vend qi quhet Tirano i permendun per djathë e kështu edhè n’Ungeri nji vend tjetër qi thirret Tirana. Në fjaluer të Kalepinit quhet Tyropatina, nji tortë (amelcinë) e ngurtë si djathi e cilla perbâhet me tamel, miell e mjaltë në gjâsim t’asajë amelcinë qi bâjnë Tiranasit e Dibranët e qi shkojne tuj e shitë neper rruga tuj bertitë: terhan, terhan.

Në fjaluer të pergjithshem gjeografik — qi âsht 10 Blêjsh, i shtypun në Venedik vj. 1826 në shtypshkrojen Giuseppe Antonelli, lexohet se: Terran — Tiran — Tyran o tyranna, gjytet i Turkís europiane, kryevend Pashnije. Por Pasha i sajë banon jashtë gjytetit në nji kështjell rrethue me mure, brijave të cillit ngrehen pyrgje. Njehë 700 shpí drûni, etj.

Por t’a lâm emnin Tiranë e të vijojmë legjenden qi pershkruen Degrand-i: „Tuj mos pasë çka me bâ tjetër as per të vett as per Tiranë, Sylejman Pasha muer persrî rrugen e Persís kû vazhdote lufta. Plague në nji luftim, kje bajtë e çue në Bagdad kû edhè diq. Si mbas dishirit, trupi i tij kje balsmue e çue në Tiranë. Zembra e tij gjindet në Bagdad me nji qoshk kû lexohet ky n’shkrim: Këtû âsht vorri e zembra e trimit dhe e bujarit Barhime Zâdé Sylejman Pasha.“

„Trupi i tij gjindet në Tiranë në qoshk perbri xhamís së njoftun me emen Eski Xhami (Xhamija e vjeter). I biri, Ahmet Pasha (shikjo fig. 19) i ngrehi nji minare edhè nji çesme; Ahmet Pasha nip i ktij të mramit djal’ i Brahim Pashës, bâni me goditë nji qyng sa me ujitë gjytetin edhè fushen per-rreth. Rrethoj banen e vet „Kulla e Gjatë“ me mure jo mâ pak se m. 3½ trashë me m. 20 naltësi; në qander të sajë naltohej edhè nji kullë qi vijte m’u rrethue në rasë luftimi, zakon i marrun prej të gjitha familjeve të para në Shqypní në Kohë të Mesme. Kjo ndertesë e bukur, mâ vonë kje prishë e disá lulekra dritoresh zbukurojnë tesh dritoret e xhamís së motshme, qi xûeme në gojë sypri; prej pallatit s’kan teprue veçse dera e madhe e nji burg nen dhé.“

Permbyllja e Degrand-it duhet modifikue disi e caktue mâ mirë. Aj qi po shkruen kta rreshta, në Korrik të vjetës 1928, percjellë nga Zot. Njazi Beg Tirana hyête në shpin mâ të motshmen e gjytetit, në Pallat Presidencjal sot Pallat Mbretnuer kû kje pritë nga Zot. Enver Beg Libohova i brezit

→

të Selim Pashë Tiranës e nga e âma bi Toptajsh e, me gjith se moti ishte i lig nuk la pa marrë me aparat të vetin fotografin e shpis e fotografin e të zotit të sajë (shikjo fig. 60), gjithashtu fotografoj edhè shpin tjetër perbri e quejtun „Kulla e Gjatë“ (shikjo fig. 61) t'Ahmet Pashë Tiranës qi ka mure shum të trasha e nji sallë të bukur, mâ e motshmja qi gjindet në Tiranë. Kjo shpí âsht tepricë e shpijave t'Esad Pashë Toptanit pshtue nga zjermi.

Ahmet Pasha; ishte fjalamel trupi i tij ishte i madh fort; e me nji fuqí të jashtzakonshme, shijimi i tij prrallues: diq prej pikës tuj lânë kater varza fort të vogla. E shoqja qi nuk ishte por e ama e atyne varzave, kje çue bashkë me to tu Sylejman Pasha i Peqinit me të cillin u martue pa vullndet të rajës së sajë të cillët u çuene e u futne në kështjell natën, e shtrenguene Pashen me hikë. E shoqja, frigjue, disá dit mbas hikës së tij, hiku edhè ajo tu të vett në Shkoder tuj marrë me vedi të gjith gjanat e arit qi mujt me marrë.

Agallarët e shpis tuj drashtë mos të ndollin ngatresa, u munduene m'u miqsue me ndo'i familje të madhe prandej i u suellen Kaplan Pashës per të cillin kena me folë mâ andej tuj e lutë të merrte per kater djel të vet kater varzat e Ahmet Pashës. Me i u bashkue sundimit të tyne pasuni aq me randësi, per trashigimtarët e themeluesit të Tiranës, ishte punë e madhe gjâ qi perkonte me shpirtin e famijes Toptani. Kater martesët kjene kremtue me të madh lulzim e në vj. 1798, shpija e Toptajve erdh e nguli në Tiranë. T'i vêhet shêj mirë datës në të cillen Toptajt erdhne në Tiranë. Per ket familje e per rrjedhen e sajë kemi me folë mâ andej.)

[*) Difton Zot. Njazi Beg Tirana se Adem Agë Toptani † 1780, ka dekë perpara se të vite në Tiranë familja e Toptajve. Mbi rrasen e vorrit t'Adem Agës, lexohen kto fjalë: «Adem Agë Toptani i biri i Ibrahim Agës djalit të mram t'Ali Beut». Ky dokument, pa dyshim, qe me pá se familja e bajte ket emen perpara se të birt e Kaplan Pashës të merrshin bijat e Ahmet Pashë Tiranës.]

Bashkimi i kësaj martese katërshe do të delte i rrezikshem, tuj ndjellë edhè mâ mnin e inatin qi kishin kundra kryetarit per me i qitë kundershtime të reja.

Sundimtari i Shkodrës, Ibrahim Pasha, filloj mizorit. Gjini sikurse ishte me kater nuset, kishte shpresue se ato do t'i kishin me ardhë tuk aj si vjeherr qi ishte e se do të kishte administrimin e pasunive të mdhaja të tyne. Idhnue si pat marrë vesht se Kaplan Pasha me i dalë punës perpara, kishte ngulë në Tiranë, u vûe në krye t'aradheve të veta qi mujt me mbledhë e u drejtue me hapa të shpejtë kah Tirana. Mbrri në Lapracë, vend jo fort larg, kje prekë në vesh prej nji kandrre: me gjith dhimë qi ndiete, hŷni në gjytet e diq (1799) ndërsa ushtarët ishin dhanë me qitë në tokë deren e madhe të kështjellit.

Deka e tij, në vend me fashitë punë i bâni mâ t'egjer; të msyemit kje i mndershem, Kaplan Pasha u mundue me i a ndalue turrin por kot; mbasi s'mujt me qindrue hiku në Krue. Të bjerrunt e Tiranës ishte të bjerrun i randë per lakmin të tij. Dergoj të birin Sylejmanin në Janinë i cilli xuer prej Ali Pashë Tepelenës nji trup të vogel ushtarësh, me të cillët mujt me shti në dorë persrî pasunit e veta. Si kthej në Tiranë, në sajë të fuqís së familjes së vet, mujt me jetue qetsisht por, shpirti i tij trubullues e shtyni nder aventura tjera. Tuj pasë marrë vesht se Jusuf Begi i Dibrës lidhë me Sundimtarin e Shkodrës, mendote me i rá Matit, aj u bâ me këta e, msyni Dibren prej kah kje xjerrë dhunisht e n'e hikun i u desht me ra neper Qer e Strugë per me mbrrî në Tiranë.

Aj ishte nji nder ata qi s'bluejnë tjetër në mende të tyne veç ahmarrje e gjak: karakteri i tij luftár i kish pertrî anmiq shum, sa mos m'e lânë me jetue qetsisht. Per sa ndej në Krue, i erdh n'at gjytet nji dervish



Fig. 60 Shpija e Enver Beg Libohovës fot. P. A. F.

Begtashí, emnit Sheh Mimi, i cilli u ndal aty i quem, thonë, prej Ali Pashë Tepelenës, qi perkrahte at sektë. Ky sheh mbrrijti me propagandë të rrebtë të veten me e rritë me nji herë numrin e besimtarve, të cillët bâheshin ndihmë e çmueshme per Ali Pashen, per Kaplanin e besidhunt e tyne.

Në vj. 1807 ky sheh ngrehi në Krue nji teqe kû xûe vend bashkë me dervishat e vet.

Pak ka-pak krenija e tij xû me rá: ndoshta ishte këndë shitë sundimtarit të Shkodrës? Por, si mundet m'u thanë per pa pasun provna? Me gjith këtë filloj me shkue keq me Kaplanin e partizanët e Toptajve: influenca besimtare e tija e bâte kundershtar fort të rrezikshem prandej Kapllani tuj u pá vetin në zgripe i çoj fjalë me i kputë drejtë e lojrat e me dalë prej gjytetit. Shehi qi e muer vesht se ish diktue, e tuj e pá rrezikun e situatës të vet, detyroj njenin nder dervisha të vet m'e shkapullue prej sundimtarit të Kruës.

Ky rregulltar hŷni në kështjell; ishte ditë e xêtë e ditë e ramë; agallarët e sherbtorët flêjshin. Kapllan Pasha qi porsë kotej në nji salë, u zgjue prej zhurmës qi bâni rregulltari dhe e pyeti çka dote; pa i u pergjegjë, ky i paraqiti nji leter të Shehit; tuj e pá atëherë Pashen kthellue në leximin e asajë leter, xuer nga petku i vet nji tepér (nji soj jataganit me dy teha) e matej me i a ngulë, kúr Kapllani qi pá levizjen e tij hoq pistolen edhè e mbyti me nji të shtime. Në krizem të pushkës ngane dy agallarë e páne zotnin e vet me pushkë në dorë qi e kish mblue tymi: „trathtarë jeni, u bertiti, keni lânë me hŷe ket qên e bir qênit que prej Baba-hit per me më mbytë: në mos daçi me jau bâ edhè jú kështu, gjêni kryetarin t'uej e shkoni shpejt tu aj per-ndryshej ju kam mbytë.“

Dy agallarët, nder të cillët njeni quhej Beqir Ali, mbasi muerne me vedi edhè tre vetë tjerë, u mshehne në teqe dy orë mbas mjesditet; dera e qelís së Shehit ishte çilë, aj po lexote, kúr u rrxue me dy plumba qi i ráne. Familjet e këtyne gjaksorve, thotë Degrand-i, janë endè (1901) e jetojnë teper vorfnisht. Dy mbytjet pertrîne paknaqësi në popull të Krues i cilli shkote gati krejt me at sektë, prandej Kaplan Pasha dau me xânë vend në Tiranë.

Lajmue se njeni nder dhandurrë të tij, Ibrahim Begu i Kavajës, qi ishte beqtashí, kishte permedue se dote me ahmarrë deken e Shehit, e grishi afer vedit e, pá keqyrë gjiní e ligjë perbûjtje, e burgosi në kështjell të Krues e bâni per vedi pasunit e tija.

E bija qi gjindej në Kavajë, i dergoj nji leter per qehajen e sajë tuj lypë të falun per të shoqin. Nsa ishin tuj kuvendue, i derguemi xuer prej xhepi nji kutí burrnoti me dy pár fundna, e çili, muer nji hundë-burrnot e e thoq me aq andje sa Kapllan Pasha qi e pite edhè aj burrnotin, e kundroj me çudí. „Më duket se paske burrnot të mirë!“ Une, pergjegji tjetri, kujtoj se kurrkush s'e ká mâ të mirë, e tuj sjellë me mjeshtirí fundin e kutís i a qiti para t'urdhnote me marrë (burrnot t'helmatisun). Kishte dalë prej kështjellit kúr Pashen e kapne dhima të fórta në krye e të pështjellët e diq shi n'at natë, vj. 1816. N'e nesre, pa ague drita mirë, perpara se të merrej vesht, nji qerre me dy buej, bajte trupin e tij t'errët e të pa-pushim, në pushim të përjetshëm.

I biri, Abdyl Rahman Begu, u bâ kryetari i shpis e desht me ahmarrë t'an prandej urdhnoj me prishë Kavajen e me i dhanë deken Brahim Begut, i cilli hiku e lypi mndoren e sundimtarit të Shkodrës i cilli e pranoj me shart qi me msyë bashkë me të Tiranën. Lufta ngjati pesë muej e gjyteti kje rrenue; partizanët e Toptajve disá kjene mbytë e kështjellet e tyne djegë. Edhè pse thye, Abdyl Rahman Begu, s'e buer shpresen e vazhdoj në qindresë. Xuer fëmijt e i çoj në Krue por mbasi ndima qi pritte s'i erdh, u drodh në Mat.

Gjith-shka pat mbetë në kështjell kje perdá prej gjinove të Shkodrës, permbi të cillen gjâ sundimtari kishte lânë si administratuer nji prej gjinís së vet, Haxhi Etëhem Begun e Muletit qi muer drejtimin e ktij çiflliku të hapët. Por nuk gzoj shum n'at kambë pse në vj. 1820 persí pat mbarue xhamin qi bán emnin e tij, Abdyl Rahman Begu me ndihmë të gjith atyne partizanve qi mujt me mbledhë e xuer prej Tirane e hŷni persrî në sundim të zotnive të vet.

Lufta me Shkoder e Kavajën ngjati edhè disá vjet pá ndonji rezultat. Sundimtari i Shkodrës kje gjikue per dekë (firmanlí) prej Sulltan Mahmudit e Abdyl Rahman Begu bashkë me të vetët u fut nder arat dhe mberthone qi rrethojshin Shkodren.

Sa per Brahim Begun e Kavajës, ky kje xânë per urdhen të Sulltanit e gjâja e tij kje konfiskue, por të birt muerne nga arka mbretnore, deri në vj. 1901, e per mâ vonë nuk e dijmë, 3000 grosh në muej d. m. th. 6700 fr. ari në vjetë. Brahimi mandej, kje çue në mergim në Kutace n'Anadoll, prej kah mujt me hikë; nisë me nji barkë diq në pak orë, si duket, i helmatisun ... [sic.] /Telegrafi/




Fig. 61 «Kulla e Gjatë» e Ahmet Pashë Tiranës fot. P. A. F.



sport



KOSOVA SONTE LUAN 'FINALEN' NDAJ IRLANDËS PËR VENDIN E DYTË

DUBLIN, 16 NËNTOR - Kombëtarja e Kosovës sonte në Dublin do ta zhvillojë ndeshjen vendimtare kundër Irlandës, në garën për vendin e dytë në Grupin B3 të Ligës së Kombeve. "Dardanët" kanë nevojë për së paku një barazim për ta siguruar matematikisht pozitën e dytë në grup. Në rast të një rezultati të tillë, Kosova do t'i mbyllte garat me shtatë pikë, ndërsa Irlanda do të mbetej me pesë.

Aktualisht, Austria kryeson grupin me 11 pikë dhe e ka siguruar vendin e parë, si dhe promovimin në Ligën A. Kosova renditet e dyta me gjashtë pikë, ndërsa Irlanda është e treta me pesë. Izraeli ndodhet në pozitën e fundit me tri pikë.

Kosova deri më tani ka regjistruar një fitore, tri barazime dhe një humbje. Fitoren e vetme e ka arritur pikërisht ndaj Irlandës, në ndeshjen e parë të zhvilluar në Prishtinë, të cilën e ka fituar me rezultat 1:0.

Në vazhdim të garave, skuadra e Franco Fodës ka pësuar humbje 3:1 nga Austria, ka barazuar pa gola me Izraelin, ndërsa ndaj Austrisë në Prishtinë ka luajtur 1:1. Në ndeshjen e fundit, të zhvilluar kundër Izraelit, Kosova ka barazuar sërish 0:0.

Në pesë ndeshjet e zhvilluara, "Dardanët" kanë shënuar tri gola dhe kanë pranuar katër, duke grumbulluar gjashtë pikë.

Irlanda, në anën tjetër, ka pesë pikë dhe i duhet vetëm fitorja në Dublin për ta kaluar Kosovën në renditje dhe për ta përfunduar grupin në pozitën e dytë. Kjo e bën përballjen e sotme një ndeshje me peshë të madhe për të dyja përfaqësueset.

Për Kosovën, ruajtja e vendit të dytë është e rëndësishme edhe për mundësinë e pjesëmarrjes në plejofin për promovim në Ligën A. Po ashtu, pozita përfundimtare në Ligën e Kombeve ndikon në përcaktimin e vazove për shortin e kualifikimeve të Kampionatit Evropian 2028, që pritet të mbahet më 6 dhjetor.

Pa Veldin Hoxhën dhe Edon Zhegrovën, të cilët mungojnë për shkak të kartonit të kuq,



përkatësisht lëndimit, Kosova do të kërkojë një rezultat pozitiv në Dublin për ta ruajtur pozitën e dytë. Përballja ndërmjet Irlandës dhe Kosovës është e fundit për të dyja skuadrat në këtë edicion të fazës së grupeve të Ligës së Kombeve. Kjo ndeshje luhet duke filluar nga ora 20:45.

ADEMI, MESAZH FUTBOLLISTËVE SHQIPTARË: NËSE NUK E ZGJIDHNI KOSOVËN, ZGJIDHENI SHQIPËRINË

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka folur për pritshmëritë ndaj Kombëtares, afrimin e talenteve shqiptare nga diaspora, raportet me Shqipërinë dhe kontributin e shteteve mike, veçanërisht të Zvicrës, në zhvillimin e Kosovës. Në një intervistë për "albinfo.ch", Ademi ka theksuar se Kosova dhe Shqipëria duhet ta shohin potencialin e futbollistëve shqiptarë si pasuri të përbashkët, duke vlerësuar se zgjedhja e njërit apo tjetrit shtet nuk duhet të shndërrohet në rivalitet negativ.

"Çdo shqiptar duhet të luajë aty ku i rreh zemra. Natyrisht, ne dëshirojmë që futbollistët ta zgjedhin Kosovën, por nëse nuk vijnë te ne, le të luajnë për Shqipërinë", ka deklaruar Ademi.

Duke folur për rezultatet e Kombëtares, ai ka thënë se pritshmëritë e tifozëve dëshmojnë rritjen e besimit në ekip, por ka kërkuar edhe realizëm, duke rikujtuar se Kosova ka vetëm dhjetë vjet në futbollin ndërkombëtar. Sa i përket ndeshjes ndaj Izraelit, Ademi ka vlerësuar se Kosova është dashur të fitojë, por ka theksuar se futbolli është i paparashikueshëm. Ai ka pranuar se rezultati e ka vështirësuar objektivin për "play-off", ndërsa ka thënë se ekipi vazhdon të jetë në procesin e ndërtimit dhe të ndërrimit të gjeneratave.

Talente nga Kosova dhe diaspora

Ademi ka vlerësuar projektin e përbashkët me trajnerin Franco Foda për identifikimin dhe afrimin e futbollistëve shqiptarë që zhvillohen në diasporë, veçanërisht në Zvicër dhe Gjermani. Ai ka bërë me dije se FFK-ja ka një sistem të organizuar në shtatë rajonet e futbollit në Kosovë, ku përcillen rreth 300 futbollistë dhe përzgjidhen më të mirët për ekipet kombëtare të grupmoshave.

Aktualisht, sipas tij, Federata monitoron 168 futbollistë të moshave të ndryshme, ndërsa organizon edhe kampe për identifikimin e talenteve në diasporë.

Duke folur për Erblin Osmanin, talentin 17-vjeçar të Bayern Munichut, Ademi ka shprehur bindjen se ai mund të bëhet një nga futbollistët kryesorë të Kombëtares. "Erblini është një fenomen. Nuk është rastësi që



një futbollist 17-vjeçar arrin të debutojë me ekipin e parë të Bayern Munichut", ka thënë ai, duke shtuar se Osmani mund të bëhet edhe lider i ardhshëm i Kosovës.

Duke komentuar zgjedhjen e futbollistëve shqiptarë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, Ademi ka përmendur edhe rastin e Lutfi Dalipit, me prejardhje nga Lugina e Preshevës, i cili ka vendosur ta përfaqësojë Kosovën. Ai ka thënë se Federata e ka përcjellë zhvillimin e tij dhe e ka ftuar ta njohë nga afër projektin e saj, pa i bërë premtime të parealizueshme. Sipas Ademit, të dyja kombëtaret duhet ta shohin potencialin e futbollistëve shqiptarë si një mundësi për zhvillimin e futbollit shqiptar.

"Zvicra dhe diaspora kanë dhënë shumë për Kosovën"

Presidenti i FFK-së ka vlerësuar kontributin e Zvicrës në zhvillimin e Kosovës, duke theksuar se ky shtet u ka krijuar mundësi të shumta shqiptarëve për të jetuar, punuar dhe shkolluar. "Zvicra është një nga shtetet mike që i ka dhënë shumë Kosovës, politikisht, ekonomikisht dhe në aspektin shoqëror", ka deklaruar ai.

Ademi ka kritikuar edhe fishkëllimat ndaj himneve të shteteve kundërshtare, duke kërkuar nga tifozët që ta dallojnë rivalitetin sportiv nga respekti ndaj shteteve mike.

"Rivaliteti sportiv nuk duhet të shndërrohet në armiqësi. Në fushë secili dëshiron të fitojë, por jashtë saj duhet të ruajmë respektin dhe mirënjohjen", ka theksuar ai.

Duke folur për rëndësinë e fanellës së Kosovës, Ademi ka thënë se ajo bart historinë dhe sakrificën e popullit për liri dhe shtetësi.

"Fanella e Kosovës peshon shumë rëndë, sepse për lirinë dhe shtetin tonë është derdhur gjak", është shprehur ai.

Në fund, Ademi ka vlerësuar rolin e diasporës shqiptare në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe edukimin e gjeneratave të reja, duke theksuar se prindërit kanë merita të mëdha për ruajtjen e gjuhës, traditave dhe dashurisë për Kosovën.

Ai ka rikujtuar edhe kontributin e bashkatdhetarëve gjatë luftës, duke thënë se mbështetja e tyre vazhdon edhe sot përmes sportit dhe fushave të tjera.

"Dëshira ime është që shqiptarët, kudo që jetojnë, të vazhdojnë ta ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të kontribuojnë për përparimin e Kosovës", ka përfunduar Ademi.

Anulohet takimi në Athinë për Lojërat Mesdhetare, Rama: Ky është turpi i shtetit tonë!

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka reaguar ashpër pas anulimit të takimit në Athinë për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030", duke kërkuar llogaridhënie nga kryeministri Albin Kurti dhe Qeveria e Kosovës. Përmes një postimi në "Facebook", Rama ka renditur arsyet që, sipas njoftimit zyrtar të Komitetit Olimpik të Kosovës, kanë çuar në anulimin e takimit nga Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare. Ai ka përmendur mungesën e përgjigjeve, obligimet e papërmbushura dhe moskonfirmimin e delegacionit brenda afatit të caktuar. Rama ka shprehur shqetësimin për situatën, duke theksuar se ky takim do të ishte një nga përpjekjet e fundit për të shmangur rrezikimin e organizimit të kësaj ngjarjeje të madhe sportive në Kosovë. "Pas të gjitha paralajmërimeve, tani anulohet edhe takimi ku duhej të bëheshin përpjekjet e fundit për të mos ua humbur qytetarëve të Kosovës këtë mundësi historike! Ky është skandal! Ky është turpi i shtetit tonë!", ka shkruar Rama.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore me nr. protokollit 5210-3/26 të dates 24.08.2026 – nga Investitori "Great Plains" L.L.C, aplikues Andrew Hemphill, ku planifikohet të ndërtohet parku i energjisë diellore dhe infrastruktura përcjellëse në parcelat 70806030, me numër të parcelave: 00015-3; 00016-0; 00018-0; 00019-0; 00020-0; 00029-1; 00029-2; 00029-3; 00030-1; 00030-2; 00030-3; 00030-4; 00030-5; 00030-6; 00030-7; 00030-8; 00035-0; 00036-0; 00037-1; 00037-2; 00038-0; 00039-0; 00040-0; 00041-1; 00041-2; 00043-3; 00044-0; 00045-0; 00046-1; 00046-2; 00047-1; 00047-2; 00048-0; 00049-1; 00049-2; 00049-3; 00055-0; 00056-1; 00056-2; 00057-1; 00057-2; 00057-3; 00058-0; 00068-0; 00069-0; 00070-0; 00071-0; 00072-1; 00072-2; 00078-1; 00078-2; 00078-3; 00078-4; 00079-0; 00081-0; 00082-0; 00084-0; 00085-0; 00358-0; 00359-0; 00360-0; 00361-1; 00361-2; 00362-1; 00363-1; 00363-3; 00365-0; 00366-0; 00367-0; 00370-0; 00371-0; 00372-0; 00373-2; 00373-3; 00381-0; 00382-0; 00383-0; 00384-0; 00385-1; 00385-2; 00387-1; 00387-2; 00387-3; 00387-4; 00387-5; 00387-6; 00387-7; 00388-1; 00388-2; 00388-3; 00520-3; 00521-0; 00523-0; 00524-1; 00525-0; 00536-0; 00538-2; 00539-1; 00539-2; 00539-3; 00539-4; 00546-1; 00546-2; 00546-5; 00547-0; 00548-0; 00549-0; 00550-1; 00550-2; 00551-0; 00552-1; 00552-2; 00552-4; 00552-5; 00553-0; 00555-1; 00555-3; 00556-0; 00557-0; 00558-0; 00559-0; 00560-1; 00563-2; 00565-2, me sipërfaqe totale prej 109.838 m^2 që ndodhen në Komunën e Istogut.

Kërkesa përcakton kriteret për plotësimin e ndryshimit të Kushteve Ndërtimore të Projektit të Parkut fotovoltaik me kapacitet 75 MW në Z.K Lubovë – Istog "Great Plains", për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim mund të dorëzohen deri më dt.24.11.2026 në adresën elektronike: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara: **Kushtet Ndërtimore të propozuara: "Great Plains" L.L.C, Istog**	
Situacioni i gjërë dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 5 dhe 6 / Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtritshme nga Dielli) sipas Hartës Zonale të Komunës së Istogut	
b. Vija rregulluese – sipas paraqitjes grafike	**-** m
c. Vija e ndërtimit. – sipas paraqitjes grafike	**7-**11 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	**2.5-3 m**
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	**2.5-3 m**
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte (sip e vendosjes së paneleve dhe sip ndërtuese e nënstacionit)	**8.34%**
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	**91.66%**
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	**- %**
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	**- %**
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	7
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Mure me blloka argjile
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

REAL INVEST SH.P.K **Prishtinë, 16.112026**

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria **„Real Invest" SH.P.K.,** me numër Unik Identifikues 810002155 me adresë: Rr. „Lot Vaku" Mati 1, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.10.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **1.63 MW** ZK Gurakoc, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria **„Real Invest" SH.P.K.,** për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **1.63 MW** ZK Gurakoc, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMT siç janë:

- Vendimin Nr. 3380-2/26 dt. 30.10.2026 për korrigjimin dhe plotësimin e Vendimit për Pëlqimin Mjedisor Nr.24/2932/1-ZSP/MMPHI dt. 25.07.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendim për Caktimin e Kushteve Teknike Ndërtimore nr. 11-351-7507/35 dt. 02.04.2025 të lëshuar nga nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimi për Leje Ndërtimore, Nr: 11-351-20353/63 dt. 24.07.2026 për "Parku i Energjisë Solare futovoltaike me kapacitet 1.6 MW, ngastra katastrale 01199-13 ZK Gurakoc, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 4986 dt. 10.04.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: edon.neziri@acesolar-ks.com dhe LEGAL-LECENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

Themeluesit e biznesit "GLOWING LAKE" L.L.C. me numër Unik Identifikues: 811991068 kanë marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themeltar nga 200,000.00 euro ne 20,000,00 euro bazuar ne ligjit 06/L-16 Neni 40 i ligjit për shoqëritë tregtare.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES